

KONTRATE



AKT - THEMELIMI

UNIONI FINANCIAR I TIRANES (SHPK)

Sot me date ne Tirane te nenshkruarit

1. Edmond LEKA, i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne Tirane me date 17.05.1963, banues ne Tirane me adrese Rr.Sulejman Delvina, p.29,sh.15,ap.89
2. Niko LEKA, i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne Tirane me date 31.03.1961, banues ne Tirane me adrese Rr.Sulejman Delvina, p.29,sh.15,ap.89
3. Leonard NIMALI, i biri i Sotiraqit dhe i Viqes, lindur ne Tirane me date 28.08.1963, banues ne Tirane me adrese Rr.Vaso Pasha, p.25, sh.1, ap.5.
4. Genc MEZINI, i biri i Nesipit dhe i Esmase, lindur ne Tirane me date 21.10.1962, banues ne Tirane me adrese Rr. B.Shqiperia e Re, p. Agimi, sh. ,ap
5. Luleta SHYTI, i bija Hakiut dhe Hajrie, lindur ne Kavaje me date 10.03.1941, banuese ne Tirane me adrese Rr. Asim Vokshi, p.2, sh.2, ap 29.
6. Eduard SHIMA, i biri i Fejziut dhe i Haxhirese, lindur ne Tirane me date 1 .11.1960, banues ne Tirane me adrese Rr.M.Shyri
7. Adrian SHEHU, i biri i Ramizit dhe i Ernestes, lindur ne Tirane me date 11.08.1961, banues ne Tirane me adrese Rr. Sami Frasheri, p.9, sh.2, ap.13.
8. Saimir DEDE, i biri i Dashamirit dhe i Dhurates, lindur ne Tirane me date 02.04.1969, banues ne Tirane me adrese Rr.Kavajes, p.155/1, sh.2, ap.5.
9. Gjergj MISHA, i biri i Nikos dhe i Sofikes, lindur ne Bukuresht (Rumani) me date 11.05.1957, banues ne Tirane me adrese Rr. Sami Frasheri, p.13, sh. 2, ap.13.

te gjithë madhore dhe te afte te kryejne veprime juridike, vendosin me vullnetin e tyre te lire per sa me poshte vijon:



- Neni 1 Te themelojne midis tyre nje shoqeri tregtare te tipit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.
- Neni 2 Jetegjatesia e shoqerise eshte e pacaktuar.
- Neni 3 Emertimi i shoqerise do te jete UNIONI FINANCAR I TIRANES sh.p.k., me seli ne adresen Rr. Reshit Collaku p.2, Tirane.
- Neni 4 Shoqeria do te kete per objekt:

- aktivitetin financiar
 - te kambizmit,
 - te menexhimit te fondeve,
 - te shitblerjes se letrave me vlere
 - te transferimit te kapitaleve.
 - te transaksioneve
- aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe administrimit
- aktivitetin e marketingut, agjentit komisionar apo perfagesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
- dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5 Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga:

1 - Kontributet ne para

Ato sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim, ne Banken Kombetare Tregtare Tirane, siç rezulton edhe nga çertifikata e leshuar nga banka e mesiperme, nga:

NR Emri i pjestarit		Kontributi ne USD
1	Edmond LEKA	15.700 (pesembedhjetemije e shtateqind)
2	Niko LEKA	15.000 (pesembedhjetemije)
3	Leonard NIMALI	11.100 (njembedhjetemije e njeqind)
4	Genc MEZINI	6.500 (gjashtemije e peseqind)
5	Luleta SHYTI	4.800 (katertemije e teteqind)
6	Eduard SHIMA	5.000 (pesemije)
7	Adrian SHEHU	5.000 (pesemije)
8	Saimir DEDE	5.000 (pesemije)
9	Gjergj MISHA	5.000 (pesemije)
TOTALI		73.100 (shtatedhjeteteetres mije e njeqind)

Ne total shuma e kapitalit para eshte **73.100 USD**
(shtatedhjeteteetres mije e njeqind Dollare Amerikane)

2 - Kontributi ne natyre

2.1. Z.Niko LEKA, me banim Rr. Sulejman Delvina P.29,Sh.15,Ap.89 Tirane i sjell Shoqerise si kontribut ne natyre, duke filluar nga data 01.03.1995, nje mikroordinator te ri te markes AAT, si pronar i ligjshem dhe ne zoterim te plote te tij, me vlere 1.300 USD.

2.2. Z.Edmond LEKA, me banim Rr. Sulejman Delvina P.29,Sh.15,Ap.89 Tirane i sjell Shoqerise si kontribut ne natyre i sjell Shoqerise, duke filluar nga data 01.03.1995, nje Telefon/Fax te markes SAGEM te perdorur, si pronar i ligjshem dhe ne zoterim te plote te tij, me vlere aktuale 400 USD.

2.3. Znj.Luleta SHYTI, me banim Rr Asim Vokshi p.2, sh.2, ap.29, Tirane i sjell Shoqerise si kontribut ne natyre, duke filluar nga data 01.03.1995, nje printer IBM te perdorur, si pronar i ligjshem dhe ne zoterim te plote te tij, me vlere aktuale 200 USD.

Vleresimi i kontributeve ne natyre u be sipas raportit te dates 19.02.1995, te hartuar nga nje perfaqesues i caktuar nga ortaket dhe te aprovuar me unanimitet prej tyre.

3 - Totali i kontributeve:

Kontributet ne para arrijne ne	73.100 USD
Kontributet ne natyre arrijne ne	1.900 USD

Totali i kontributeve arrin ne	75.000 USD
---------------------------------------	-------------------

Kapitali themeltar me vlere 75.000 USD ne daten e regjstrimit, eshte ekuivalent me shumen prej 7.050.000 Leke duke u llogaritur me kursin ditor te kembimit te USD me Lekun te barabarte me :

1 USD = 94 Leke.

Neni 6 Kapitali themeltar 75.000 USD ndahet ne 750 pjese te barabarta me vlefte prej 100 USD secila. Ato ndahen midis ortakeve si vijon:

N	Emri	Shuma	Pjeset	Pjeset %	Nr rendor i pjeseve
		USD			
1	Edmond LEKA	16.100	161	21.47	1 - 161
2	Niko LEKA	16.300	163	21.73	162 - 324
3	Leonard NIMALI	11.100	111	14.80	325 - 435
4	Genc MEZINI	6.500	65	8.67	436 - 500
5	Luleta SHYTI	5.000	50	6.67	501 - 550
6	Eduard SHIMA	5.000	50	6.67	551 - 600
7	Adrian SHEHU	5.000	50	6.67	601 - 650
8	Saimir DEDE	5.000	50	6.67	651 - 700
9	Gjergj MISHA	5.000	50	6.67	701 - 750
TOTALI		75.000	750	100 %	1 - 750

Te gjithë ortaket e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "UNIONI FINANCIAR I TIRANES":

EDMOND LEKA, NIKO LEKA, LEONARD NIMALI, GENC MEZINI, LULETA SHYTI, ADRIAN SHEHU, SAIMIR DEDE, GJERGJ MISHA dhe EDUART SHIMA, kanë hartuar dhe miratuar këto kontrata në formën e saj të mesipërme .

Edmond LEKA




Niko LEKA




Leonard NIMALI




Genc MEZINI



Luleta SHYTI



Gjergj MISHA



Adrian SHEHU



Saimir DEDE



Eduard SHIMA



S T A T U T I
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
UNIONI FINANCIAR I TIRANES

NENI 1
EMERTIMI

1.1 Emri i shoqerise do te jete Unioni Financiar i Tiranes (me poshte do te quhet thjesht "UFT" ose Shoqeria)

NENI 2
FORMA

1.1 Unioni Financiar i Tiranes eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Te gjitha aktet e dokumentat e nxjerra nga shoqeria, do te permbajne, pervec emertimit UNIONI FINANCIAR I TIRANES edhe fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose iniciallet "sh.p.k."

NENI 3
OBJEKTI

1. Objekti i UFT eshte:

1.1 Te kryeje aktivitet financiar qe lidhet me,

- 1.1.1 Kambizmin
- 1.1.2 Menexhimin e fondeve,
- 1.1.3 Shitblerjes se letrave me vlere,
- 1.1.4 Transferimin e kapitaleve,
- 1.1.5 Transaksionet;

1.2 Te kryeje konsulence ne fushen e biznesit dhe te administrimit;

1.3 Te kryeje aktivitet marketingu, te agjentit komisionar ose perfaqesuesit per shoqerite a firmat e ndryshme te vendit ose te huaja; si dhe

1.4 Te kryeje, ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, mobiliare apo imobiliare, por edhe duke mos u kufizuar vetem ne to, sidomos kur eshte flala per aktivitete te tjera qe lidhen me qellimet e parashikuara ne pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 te ketij neni.

1.5 Shoqeria do te jete gjithashtu e afte te kryeje te gjitha llojet e veprimtarive tregtare qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

NENI 4
SELIA

1. Selia e shoqerise eshte: Rr.Reshit Collaku P.2, Tirane, Shqiperi.

2. Ajo mund te zhvendoset brenda rrethit me vendim te marre me shumicen e votave te drejtuesve, i cili duhet te ratifikohet nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme, si dhe kudo gjetke me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme.

NENI 5
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte e papercaktuar.

NENI 6
KONTRIBUTET



1. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga:

1.1 Kontributet ne para:

Ato sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim, ne Banken Kombetare Tregtare Tirane, siç rezulton edhe nga çertifikata e leshuar nga banka e mesiperme, nga:

NR	Emri i pjestarit	Kontributi ne USD
1	Edmond LEKA	15.700 (pesembedhjetemije e shtateqind)
2	Niko LEKA	15.000 (pesembedhjetemije)
3	Leonard NIMALI	11.100 (njembedhjetemije e njeqind)
4	Genc MEZINI	6.500 (gjashtemije e peseqind)
5	Luleta SHYTI	4.800 (katermije e teteqind)
6	Eduard SHIMA	5.000 (pesemije)
7	Adrian SHEHU	5.000 (pesemije)
8	Saimir DEDE	5.000 (pesemije)
9	Gjergj MISHA	5.000 (pesemije)
	TOTALI	73.100 (shtatedhjeteetre mije e njeqind)

Ne total shuma e kapitalit para eshte 73.100 USD
(shtatedhjeteetre mije e njeqind Dollare Amerikane)

2. Kontributi ne natyre:

2.1 Z.Niko LEKA, me banim Rr. Sulejman Delvina P.29, Sh.15, Ap.89 Tirane i sjell Shoqerise si kontribut ne natyre, duke filluar nga data 01.03.1995, nje mikroordinator te ri te markes AAT, si pronar i ligjshem dhe ne zoterim te plote te tij, me vlere 1.300 USD.

2.1 Z.Edmond LEKA, me banim Rr. Sulejman Delvina P.29, Sh.15, Ap.89 Tirane i sjell Shoqerise si kontribut ne natyre i sjell Shoqerise, duke filluar nga data 01.03.1995, nje Telefon/Fax te markes SAGEM te perdorur, si pronar i ligjshem dhe ne zoterim te plote te tij, me vlere 400 USD.

2.3 Znj Luleta SHYTI, me banim Rr Asim Vokshi p.2, sh.2, ap.29, Tirane i sjell Shoqerise si kontribut ne natyre, duke filluar nga data 01.03.1995, nje printer IBM i perdorur si pronar i ligjshem dhe ne zoterim te plote te tij, me vlere aktuale 200 USD.

Vleresimi i kontributeve ne natyre u be sipas raportit te dates 19.02.1995, te hartuar nga nje perfaqshues i caktuar nga ortaket dhe te aprovuar me unanimitet prej tyre.

3 - Totali i kontributeve:

Kontributet ne para arrijne ne	73.100 USD
Kontributet ne natyre arrijne ne	1.900 USD

Totali i kontributeve arrin ne	75.000 USD
---------------------------------------	-------------------

Kapitali themeltar me vlere 75.000 USD ne daten e regjstrimit, eshte ekuivalent me shumen prej 7.050.000 Leke duke u llogaritur me kursin ditor te kembimit te USD me Lekun te barabarte me :

1 USD = 94 Leke.



NENI 7
KAPITALI THEMELTAR

7.1 Kapitali themeltar fiksohet ne 75.000 USD (shtatedhjete e pese mije Dollare Amerikane)

7.2 Ai ndahet ne 7500 pjese te kapitalit themeltar prej 100 USD secila, te gjitha te nenshkruara dhe te paguara teresisht.

NENI 8
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Pjeset e kapitalit themeltar ndahen si me poshte:

N	Emri	Shuma	Pjeset	Pjeset	Nr rendor i pjesëve
		USD		%	
1	Edmond LEKA	16.100	161	21.47	1 - 161
2	Niko LEKA	16.300	163	21.73	162 - 324
3	Leonard NIMALI	11.100	111	14.80	325 - 435
4	Genc MEZINI	6.500	65	8.67	436 - 500
5	Luleta SHYTI	5.000	50	6.67	501 - 550
6	Eduard SHIMA	5.000	50	6.67	551 - 600
7	Adrian SHEHU	5.000	50	6.67	601 - 650
8	Saimir DEDE	5.000	50	6.67	651 - 700
9	Gjergj MISHA	5.000	50	6.67	701 - 750
	TOTALI	75.000	750	100 %	

NENI 9
LLOGARITE RRJEDHESE

Pervec kontributeve, ortakët mund te derdhin apo lene ne dispozicion te Shoqerise çfaredo shume qe ajo mund te kete nevojë. Per kete ata mund te vene ne dispozicion llogarite e tyre rrjedhese, vecse keto nuk duhet te figurojne asnjehere debitoare.

NENI 10
NDRYSHIMET E KAPITALIT THEMELTAR

1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet si duke krijuar pjese te reja, ashtu edhe duke rritur vleren nominale te pjesëve

ekzistuese, me ane te vendimeve kolektive te jashtezakonshme te ortakeve.

2. Kapitali themeltar mund te zvoglohet me ane te nje vendimi kolektiv te jashtezakonshem te ortakeve, por ne asnje rast ai nuk mund te preke barazine e ortakeve.

3. Reduktimi i kapitalit themeltar nen nje minimum ligjor nuk mund te vendoset pervecse me nje kusht pezullues per nje rritje te kapitalit te destinuar per ta shpene ate te pakten ne shumen e barabarte me kapitalin themeltar minimal te parashikuar nga ligji, me perjashtim te rastit kur shoqeria transformohet ne nje shoqeri te nje forme tjeter. Ne te kundert, kushdo nga te interesuarit mund te kerkoje ne rruge gjyqesore shkrirjen e Shoqerise. Kjo shkrirje nuk mund te deklarohet, ne se para shpalljes se vendimit te gjykates, ndodh rregullimi i qeshtjes.

4. Ne se zvoglimi i kapitalit çon ne shfaqjen e pjeseve jo te plota, ortaket duhet ta zgjidhin midis tyre duke e bere qeshtje personale dhenje apo marrje pjesesh te vjetra per te marre nje numur te plote pjesesh te reja.

NENI 11

NENSHKRIMI DHE PERFAQESIMI I PJESEVE

1. Pjeset e kapitalit nenshkruben teresisht dhe levrohen plotesisht nga ortaket, qofshin keto kontribute ne natyre apo ne para.

2. Pjeset nuk mund te perfaqsohen kurre nga letra te tregtueshme.

3. Pronesia mbi pjeset e kapitalit percaktohet nepermjet ketij statuti, nga aktet e mepasme qe mund te modifikojne kapitalin themeltar dhe nga leshimet apo marrjet qe jane realizuar me rregullsi.

NENI 12

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIDHURA ME PJESET E KAPITALIT

1. Cdo pjese kapitali i atribuon pronarit te saj te drejta te barabarta ne fitimet e Shoqerise, ne pronat e aktivitet dhe ne bonot e likuidimit. Ajo i jep, gjithashtu, pronarit te drejten e nje vote ne te gjitha rastet e votimeve dhe vendimeve.

2. Ortaket pergjigjen para te treteve vetem per shumen e kapitalit te kontribuar.

3. Pronesia mbi nje pjese i jep pronarit te drejten per t'u perfshire ne statut si dhe per te marre pjese ne te gjitha vendimet qe do te merren nga ortaket.

NENI 13

PANDASHMERIA E PJESEVE

1. Pjeset e kapitalit themeltar jane te pandashme para Shoqerise.

2. Bashkepronaret e pandashem jane te detyruar te zgjedhin njerin prej tyre t'i perfaqsoje prane Shoqerise. Ne mungese mirekuptimi, i takon me te zellshmit te caktoje ne rruge gjyqesore nje mandatar per t'i perfaqsuar.

3. Ne se nje ose me shume pjese jane lene ne perdorim, e drejta e votes i perket pronarit te ligjshem, pervec rastit te vendimeve lidhur me shperndarjen e rezultateve, e cila i rezervohet perdoruesit.

4. Kur nje ose me shume pjese jane lene ne perdorim, e drejta e votes i perket pronarit te ligjshem per te gjitha vendimet kolektive te jashtezakonshme dhe perdoruesit per vendimet kolektive te zakonshme.

NENI 14 TRANSFRIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

1. Cdo transferim pjesesh qe te njihet nga Shoqeria duhet te behet me akt noterial.

2. Per tu njohur nga te tretet duhet bere depozitimi ne regjistrin e shoqerive.

3. Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

4. Ato nuk mund t'u leshohen te treteve jashte Shoqerise pervecse me mareveshje te shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

5. Projekti i transferimit te pjeseve i behet i njohur Shoqerise dhe ortakeve nepermjet letres se nenshkruar te dorezuar ne prani te noterit apo nje personi zyrtar apo te nje letre rekomande me pergjigje. Ne nje periudhe prej 15 pesembedhjetë ditësh nga njoftimi drejtuesi duhet te mbledhe asamblene e ortakëve për të vendosur për projektin e leshimit të pjeseve ose të bëjë konsultën me shkrim me ortakët. Vendimi i Shoqerise nepermjet drejtuesve i behet i njohur transferuesit te interesuar zyrtarisht, nepermjet nje njoftimi me vertetim per marrjen e tij ose me ane te nje leter rekomande me pergjigje. Ne se Shoqeria nuk e ka bere te njohur vendimin brenda nje periudhe tre mujore nga njoftimi i fundit i parashikuar ne kete Statut, leja per leshimin e pjeseve konsiderohet e akorduar.

6. Ne se Shoqeria refuzon transferimin e pjeseve, ortaku qe desheron te beje transferimin, brenda pesembedhjetë diteve nga marrja e njoftimit nga Shoqeria, mund t'i beje te njohur Shoqerise se heq dore nga projekti i transferimit te pjeseve nepermjet nje njoftimi te nenshkruar te dorezuar zyrtarisht ose kundrejt nje vertetimi per marrje njoftimi, apo te derguar me leter rekomande me pergjigje.

7. Kur i interesuari nuk heq dore nga transferimi, ortakët jane te detyruar qe brenda nje periudhe prej tre muajsh nga dita qe u be refuzimi i transferimit, te blejne pjeset sipas vleresimit te bere nga nje ekspert, i cili caktohet nga palet. Kur palet nuk merren vesh ndermjet tyre, ai caktohet nga gjykata.

8. Shoqeria brenda afatit tremujor mund te bleje pjeset me çmimin e percaktuar ne kushtet e mesiperme dhe te zvogeloje kapitalin me vleren nominale te pjeseve te leshuesit.

NENI 15 VDEKJA, PAAFTESIA, FALIMENTIMI I NJE ORTAKU

1. Shoqeria nuk prishet ne rast vdekje, paaftesie ose falimentimi personal te nje ortaku.

2. Grumbullimi ne nje dore te vetme i te gjitha pjeseve te kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar nuk çon ne prishjen e shoqerise.

NENI 16
DREJTIMI

1. Shoqeria administrohet nga nje ose me shume drejtues, persona fizike, ortake ose jo, te zgjedhur nga ortaket qe perfaqsojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit, me ose pa kufizim te kohezgjatjes se mandatit.

Zoterinjte **Niko LEKA**, lindur ne Tirane me 31.03.1961, banues ne Rr.S.Delvina P.29, sh.15, ap. 89 Tirane, dhe **Leonard NIMALI**, lindur ne Tirane me 28.08.1963, banues ne Rr.V.Pasha, p.25, sh.1, ap.5, Tirane emerohen administratore te pare te shoqerise per periudhen deri ne mbyllje te aktivitetit te pare financiar.

Paga e tyre do te fiksohet nga asambleja me e afert. Ata do te rimbursohen, kundrejt faturave justifikuese, per shpenzimet e zhvendosjes dhe te perfaqsimet.

Zoterinjte **Niko LEKA** dhe **Leonard NIMALI**, deklarojne se asnje parashkrim, asnje mase apo vendim nuk i pengon ne ushtrimin e ketij mandati.

2. Paga e drtejtuesve percaktohet me vendim te zakonshem te ortakeve.

3. Cdo drejtues ka te drejte te kompensohet per shpenzimet ose dietat e ndryshme te kryera per udhetime e perfaqsimet te kryera per interes te Shoqerise, perkundrejt paraqitjes se faturave justifikuese.

4. Drejtuesit perfaqsojne Shoqerine ne marredhenie me te tretet, si dhe ushtrojne te gjitha kompetencat e te drejtat qe atyre u nihen me ligj ose me kete Statut.

5. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtuesve edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e Shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i drejtuesve e kalonte objektin e Shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e Statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

6. Ne raportet midis ortakeve, drejtuesi mund te kryeje te gjitha aktet e drejtimit ne interes te Shoqerise. Megjithate, ne kuadrin e rregullores se brendshme dhe pa qene nevoja qe keto kufizime tu paraqiten te treteve, vendoset qe drejtuesi pa qene i autorizuar paraprakisht nga nje vendim i zakonshem i ortakeve, nuk mund te bleje, shese apo te kembeje asnje lloj pasurie te patundshme, fond tregtie, te kontraktaje borxhe per llogari te Shoqerise, perveqse terheqjeve normale ne banke, venien ne hipoteke te ndonje prone te patundshme apo venien e ndonje peng ne fondin e tregtise.

7. Drejtuesit mund te shkarkohen me vendim te ortakeve qe perfaqsojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit.

8. Drejtuesit jane pergjegjes, individualisht ose solidarisht sipas rastit, kundrejt Shoqerise apo te treteve, per shkeljet e dispozitave ligjore apo rregullave te aplikuara per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, per shkeljet e statutit, apo per fajet e kryera gjate drejtimet te tyre.

9. Ne se disa drejtues jane bashkepergjegjes per nje fakt, gjykata percakton pjesen perkatese te secilit prej tyre ne shlyerjen e demit.

10. Asnje vendim i Asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkese padise kunder administratoreve per gabimet te kryera prej tyre gjate ushtrimit te detyres.

NENI 17
EKSPERTI KONTABEL

1. Ortaket mund te caktojne nje ose me shume eksperte kontabel. Pagesa perballohet nga ortaket dhe vendoset me vendim te zakonshem te asamblese.

2. Caktimi i ekspertit kontabel te shoqerise behet i detyruar kur eshte e nevojshme te permbushen kerkesat e ligjit "Per Shoqerite Tregtare" Nr.7638, date 19.11.1992.

NENI 18

MARREVESHJET MIDIS NJE DREJTUESI APO NJE ORTAKU DHE SHOQERISE

1. Drejtoria i paraqet Asamblese, duke i bashkengjitur dokumentat qe i komunikohen ortakeve, kur konsultimi behet me shkrim, nje raport mbi marreveshjet e nenshkruara midis Shoqerise dhe ndonje drejtuesi apo ortaku.

2. Asambleja vendos per kete raport qe duhet te permbaje elementet e meposhtem:

3. Pendenin e marreveshjeve qe i nenshtrohen aprovimit te asamblese se ortakeve;

- emrin e drejtuesve apo ortakeve te interesuar nga ato;
- natyren e objektin e marreveshjeve te lartpermendura;
- modalitetet kryesore te ketyre marreveshjeve, vecanerisht tregimi i çmimeve apo tarifave te praktikuar, te ardhurat dhe komisionet e lejuara, afatet e pagesave te akorduara, interesat e percaktuara, siguri te dhena dhe sipas rastit, te gjitha indikacionet e tjera qe lejojne ortaket te vleresojne interesin qe lidhet me perfundimin e marreveshjeve te analizuara;
- rendesia e mallrave te blera apo e sherbimeve te kryera, si dhe totalin e shumave te derdhura apo arketuara gjate ushtrimit te aktivitetit te fundit.

3. Drejtuesi ose ortaku i interesuar nuk mund te marrin pjese ne votim dhe pjeset e tij nuk do te merren parasysh ne llogaritjen e kuorumit dhe te shumices.

4. Marreveshjet e kryera nga nje drejtues jo ortak i nenshtrohen aprovimit paraparak te Asamblese.

5. Marreveshjet e pa aprovuara sjellin pasoja ne ngarkim te drejtuesit, dhe kur eshte rasti, edhe per ortakun kontraktues, te cilet duhet te pergjigjen individualisht ose solidarisht, sipas rastit, per keto pasoja.

6. Keto dispozita shtrihen edhe per marreveshjet e kaluara me nje shoqeri ku nje ortak me pergjegjesi te papercaktuar, drejtues, administrator, drejtor i pergjithshem, antar i drejtorise apo i keshillit mbikqyres, eshte njekohesisht drejtues apo ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

7. Keto dispozita nuk jane te aplikueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine e zakonshme dhe te mbyllura ne kushte normale.

8. Drejtuesve ose ortakeve pervec personave morale, u ndalohej qe te kontraktojne ne çfaredo forme qe te jete, borxhe prane Shoqerise, mbulimin nga ana e saj e nje zbulimi bankar personal ne nje llogari rrjedhese apo tjeter, si dhe garantimi e dorezania nga ana e saj e nje angazhimi ndaj te treteve. Ky ndalim aplikohet edhe per bashkeshortet, parardhes ose pasardhes te drejtuesve apo ortakeve si dhe ndaj te gjitha personave ndermjetes dhe perfaqesuesve legale te personave morale ortake.

Ne te gjitha rastet e siperpermendura kontrata do te konsiderohet e pavlefshme

NENI 19

VENDIMET KOLEKTIVE

1. Ortaket i marrin vendimet nepermjet drejtuesve, ne asamble ose nepermjet konsultimit me shkrim. Ato mund te rezultojne nga nje leje e dhene nga te gjitha ortaket e shprehur ne nje akt zyrtar.

2. Mbledhjet e zakonshme te asamblese jane te detyruara te behen te pakten dy here ne vit, per te vendosur mbi aprovimin e llogarive vjetore. Asambleja vendos me shumicen e votave qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfagesuar.

3. Mbledhja e asamblese eshte e detyruar ne te gjitha rastet e parashikuara ne ligji.

4. Ortaket thirren ne asamble nga drejtuesit ose me kerkesen e ortakeve qe perbejne jo me pak se nje te katerten e ortakeve ose zoterojne jo me pak se nje te katerten e pjeseve te kapitalit.

5. Thirrja behet nepermjet nje lajmerimi, i cili duhet te vertetohet me marrjen ne dorezim, ose me leter rekomande adresuar ortakeve te pakten pesembedhjete dite para dates se mbledhjes. Ajo permban rendin e dites se asamblese te percaktuar nga autori i thirrjes. Cdo asamble e thirrur jo rregullisht mund te anulohet. Megjithate veprimi i anulimit nuk pranohet kur te gjitha anetaret jane te pranishem ose te perfagesuar.

6. Asambleja e ortakeve mblidhet ne seli ose ne cdo vend tjeter te shenuar ne thirrje. Ajo drejtohet nga drejtuesi ose nje nga drejtuesit, ose kur asnjeri nga ata nuk eshte ortak, nga ortaku i pranishem, qe pranon, kur ai zoteron ose perfageson numrin me te madh te pjeseve te kapitalit. Kur dy ortake zoterojne ose perfagesojne te njejtin numer te pjeseve, dhe pranojne drejtimin e asamblese, ai realizohet nga me i moshuari.

7. Cdo vendim i asamblese se ortakeve regjistrohet ne proces verbal, qe permban shenimet rregulluese, proces verbal i cili hartohet e firmoset nga drejtuesi ose drejtuesit, dhe ne rast te kundert nga drejtuesi i seances, si dhe nga mbajtesi i proces-verbalit.

8. Ne rast te konsultimit me shkrim, drejtoria i adreson cdo ortaku me leter rekomande tekstin e vendimeve te propozuara, si dhe dokumentat e nevojshme per informacion ortakeve.

9. Ortaket kane pesembedhjete dite afat duke filluar nga dita e marrjes se projektit te vendimeve, per te transmetuar voten e tyre drejtorise me leter rekomande. Cdo ortak qe nuk eshte pergjigjur ne afatin e siperpermendur konsiderohet se ka abstenuar.

10. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendimet kolektive dhe disponon nje numer votash te barabarte me ate te pjeseve qe ai zoteron.

11. Nje ortak mund te perfagesohet nga nje ortak tjeter pervec rastit kur jane vetem dy, ose edhe nga nje i trete jo ortak, ose mund te dergoje menyren e votimit me leter rekomande.

12. Proces verbalet hartohen ne nje regjister me flete te numeruara ose me flete te shkeputura gjithashtu te numeruara ne perputhje me kushtet e rregullores.

NENI 20

VENDIMET KOLEKTIVE TE ZAKONSHME

1. Quhen te zakonshme vendimet e ortakeve qe nuk kane lidhje me modifikimet e statutit dhe me akordin per leshimin apo transferimin e pjeseve te kapitalit, te drejtes se antaresimit apo te atribuitimit.

2. Brenda gjashte muajve nga mbyllja e aktivitetit, ortaket mblidhen ne asamble per te marre vendim per llogarine e aktivitetit dhe per shperndarjen e rezultateve.

3. Vendimet e zakonshme adoptohen me shumice prej ortakeve qe zoterojne e perfagesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit. Ne se kjo shumice nuk arrihet, vendimet merren me shumicen e votave te dhena, cilido qofte numri i votuesve.

4. Vendimet per emerimin ose shkarkimin e nje drejtuesi merren vetem prej ortakeve qe zoterojne shumicen absolute te pjeseve te kapitalit. Vendime te tilla nuk mund ti nenshtrohet nje votimi me shumice te thjeshte te votave te dhena.



NENI 21

VENDIMET KOLEKTIVE TE JASHTEZAKONSHME

1. Asambleja mund, vetem me vendime te jashtezakonshme, te modifikojë Statutin ose te akordojnë dhenjen apo transferimin e pjeseve te kapitalit, te drejten e antaresimit dhe te atribuimit.

2. Vendimet e jashtezakonshme konsiderohen te vlefshme kur ato jane adoptuar:

2.1 Me unanimitet, ne rast te ndryshimit te nenshtetesise se Shqerise, te shndrrimit te Shqerise ne shoqeri kolektive, ne komandite te thjeshte, ne komandite me aksione apo ne shoqeri civile.

2.2 Me shumicen e ortakeve, qe perfaqsojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit, ne rastin e pranimit te ortakeve te rinj apo te autorizimit te dorezaneve se pjeseve.

2.3 Me shumicen e ortakeve qe perfaqsojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit per te gjitha vendimet e tjera te jashtezakonshme.

NENI 22

E DREJTA E KOMUNIKIMIT, INFORMIMIT DHE E KONTROLLIT TE ORTAKEVE

1. Cdo ortak ka te drejten e nje komunikimi te vazhdueshem, shtrirja dhe menyra te ekzekutimit te te cilit percaktohen me dispozitat ligjore, Statutin e rregulloret ne fuqi.

2. Para cdo asambleje apo konsultimi me shkrim, ortaket kane te drejten e informimit me dokumentet e te informacioneve te tjera qe u drejtohen ose qe u vihen atyre ne dispozicion ne konditat e fiksuara nga dispozitat ligjore e rregulloret ne fuqi.

3. Cdo ortak jo drejtues mundet, dy here ne vit, te beje me shkrim pyetje drejtuesve per cdo fakt qe ka te beje me komprometimin e vazhdimesise se aktivitetit. Pergjigja me shkrim e drejtuesve duhet jepet brenda nje muaji.

4. Nje ose me shume ortake qe perfaqsojne te pakten nje te dhjeten e kapitalit themeltar, individualisht apo ne grup, mund te kerkojne prane gjykates, kur nuk bien dakort vete, caktimin e nje ose me shume eksperteve te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti mbi nje ose me shume operacione te drejtuesve. Kushtet e emerimit dhe te ushtrimit te ketij misioni parashikohen me ligj dhe me rregullore.

NENI 23

AKTIVITETI I SHOQERISE - LLOGARITE E SHOQERISE

1. Cdo aktivitet social ka nje kohezgjatje prej nje viti, qe fillon ne 01.04 te cdo viti dhe perfundon ne 31.03 te vitit pasardhes.

2. Si perjashtim, aktiviteti i pare fillon ne ditën e regjistrimit te Shqerise ne Regjistrin e shoqerive tregtare dhe mbaron ne 31.03.1996.

3. Ne mbylljen e çdo aktiviteti vjetor, drejtuesit hartojne nje inventar te aktivitetit te pasivitetit te Shoqerise, si dhe llogaritje vjetore (bilanc, llogari humbje-fitim, rezultat vjetor).

4. Shuma e angazhimeve si garanci ose peng e Shoqerise i bashkohet aneksit te bilancit, sikurse edhe nje situacion te leshuara prej saj.

5. Drejtuesit hartojne nje raport per situaten e Shoqerise dhe aktivitetin e saj pergjate vitit te shkuar, rezultatet e ketij aktiviteti, progresin e realizuar dhe veshtiresite e hasura, parashikimin per evoluimin e situates, dhe perspektiven ne te ardhmen, evenimentet e rendesishme te ndodhura midis dates se mbylljes se aktivitetit dhe dates ne te cilen paraqitet raporti, dhe se fundi aktivitetit e lidhura me fushen e kerkim zhvillimit.

6. Drejtoria vijon punen edhe ne rast mungese apo panjafueshmërie fitimesh apo rezervash e kuotash amortizimi te nevojshme, derisa nje gje e tille eshte e mundur.

7. Ne rastet e mbylljes se aktivitetit, drejtuesit jane te detyruar te hartojne nje situacion te aktivitetit te realizuar dhe disponibël, te pasivitetit te kerkuar, nje parashikim te shpenzimeve te ardhurave, nje tabelë financimesh, si dhe nje bilanc vjetor e nje plan financimi parashikues, ne kushtet dhe sipas periodicitetit te parashikuar me ligj apo vendim.

8. Llogaritje vjetore, raporti i drejtorise dhe teksti i rezolutave te propozuara i vihen ne dispozicion Ekspertit Kontabel te pakten nje muaj para thirrjes se asamblese. Po keto dokumenta, dhe sipas rastit, raporti i Ekspertit Kontabel, i adresohen ortakeve te pakten pesëmbëdhjetë dite para dates se asamblese qe thirret per tu shprehur per analizen financiare.

NENI 24

PERCAKTIMI DHE SHPERNDARJA E FITIMEVE

1. Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i aktivitetit gjate vitit financiar, zvogluar me humbjet e meparshme dhe shumat e vendosura ne rezerve ne zbatim te ligjit dhe te statutit. Ky fitim shperndahet midis te gjithë ortakeve proporcionalisht me numrin e pjeseve qe i perkasin secilit prej tyre.

2. Nga ky fitim, i zvogluar me humbjet eventuale te meparshme, hiqen shumat per rezerve ne zbatim te ligjit, dhe veçanerisht perkundrejt anulimit te mundshëm te çdo vendimi te kundërt, nje shume qe i korespondon nje te njezëtes per krijimin e fondit te rezervës legale. Kjo heqje (derdhje) pushon se qeni e detyruar kur fondi rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar.

3. Asambleja e pergjithshme mund te vendose shperndarjen e shumave te marra nga rezervat te cilat ajo i disponon duke treguar shprehimisht llojet e rezervës mbi te cilat jane kryer keto marrje. Megjithate, dividendet shkeputen ne menyre prioritare nga fitimi i shperndarshëm i aktivitetit.

4. Menytrat e pageses se dividendeve te votuar nga Asambleja e Pergjithshme fiksohen nga ajo vete ose nga drejtuesit.

5. Pagimi i dividendeve duhet te kryhet brenda nje afati maksimal prej nente muajsh pas mbylljes se aktivitetit, perveçse kur ky afat zgjatet nga gjykata.

6. Asnje shperndarje nuk mund te behet kur kapitali bashke me rezervat eshte ose do te behej pas shperndarjes me i vogel se shuma e kapitalit te percaktuar me ligji.

7. Asambleja e Pergjithshme mund te vendose gjithashtu te kaloje shumat e shperndarshme ne rikapitalizim, totalisht apo pjesërisht.

NENI 25

KAPITALI ME I VOGEL SE GJYSMA E KAPITALIT THEMELTAR

1. Ne se per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat kontabel, kapitalet e Shoqerise behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, drejtoria, brenda kater muajve qe pasojne aprovimin e analizës financiare qe paraqet kete humbje, duhet te konsultojë ortaket me qellim qe te vendose, ne se ka vend per shkrirje paraprake te Shoqerise.

2. Ne se shkrirja nuk prononcohet, kapitali, ne zbatim te dispozitave ligjore lidhur me kapitalin minimum ne shoqerite te pergjegjesi te kufizuar dhe ne afatet e percaktuara nga ligji, duhet te zvoglohet ne masen e barabarte me humbjet qe nuk mund te perfalleshin nga rezervat ne se nderkohe kapitali nuk eshte paraguar te paktën me gjysmen e kapitalit themeltar.

3. Ne te gjitha rastet, vendimi i Asamblese se pergjithshme duhet te publikohet brenda kushteve ligjore.

NENI 26

SHNDRRIMI I SHOQERISE

1. Shndrrimi i Shoqerise ne nje shoqeri te nje tipi tjeter vendoset nga ortaket me ate shumice qe eshte e nevojshme per te modifikuar Statutin.

2. Shndrrimi ne shoqeri anonime vendoset me shumicen e kerkuar per modifikimin e statutit. Megjthate, ajo mund te vendoset nga ortaket qe perfaqsojne shumicen e pjeseve ne se kapitali i saj arrin shumen prej njezet milion leke.

3. Vendimi per shndrrim ne shoqeri anonime paraprihet nga nje ose disa raporte te eksperteve kontabel, te caktuar me unanimitet nga ortaket, ose kur nje gje e tille nuk arrihet, nga gjykata, te cilet ngarkohen per te vleresuar nen pergjegjesine e tyre vleren e pasurive qe perbejne aktivin dhe avantazhet e veçanta. Ekspertet per shndrrim mund te ngarkohen per formulimin e nje raportit mbi situacionin e Shoqerise. Ne kete rast, redaktohet vetem nje raport. Eksperti kontabel i Shoqerise mund te emerohet ekspert per shndrrim.

4. Ortaket vendosin per vleresimin e pasurise dhe dhenien e avantazheve te veçanta; ata nuk mund t'i zvoglojne perveçse me unanimitet. Ne mungese te aprovimit te shprehur te ortakeve te permendur ne proces-verbal, shndrrimi eshte i pavlefshem.

NENI 27

SHKRIRJA - LIKUIDIMI

1. Shoqeria shkrihet ne rast te realizimit ose shuarjes se objektit te saj ose me vendim gjyqesor.

2. Shkrirja para afatit mund te vendoset ne çdo moment nga ortaket qe perfaqsojne tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

3. Shoqeria vihet ne likuidim qe nga momenti i shkrirjes se saj per çfaredo arsye qofte.

4. Personi moral i Shoqerise vazhdon, per nevoja te likuidimit, deri ne perfundimin e tij. Shkrirja e Shoqerise jep efekte ndaj te treteve vetem nga data kur ajo publikohet ne regjistrin e shoqerive tregtare. Emertimi "shoqeri ne likuidim" duhet te shenohet ne te gjitha aktet e dokumentat qe dalin nga Shoqeria.

5. Funksionet e drejtimit dhe drejtuesve perfundojne me shkrirjen e Shoqerise. Kolektiviteti i ortakeve ruan fuqite dhe regullon menyren e likuidimit; ai emeron nje ose me shume

5. Funkcionet e drejtimit dhe drejtuesve përfundojnë me shkërrjen e Shoqërisë. Kolektiviteti i ortakëve ruan fuqite dhe regullon menyrën e likuidimit; ai emeron një ose me shumë likuidatore, të zgjedhur ndër ose jashtë ortakëve, dhe përcakton fuqite e tyre. Likuidimi bëhet konform ligjit.

6. Pas rimbursimit të shumës së pjesëve të kapitalit, bono e likuidimit ndahet midis ortakëve, në përputhje me numrin e pjesëve që i takojnë secilit prej tyre.

7. Në rast të bashkimit të gjithë pjesëve në një dorë të vetme, nëse paraqitet rasti për likuidim atëherë kemi vetëm transmetim universal të pasurisë pa pasur nevojë për likuidim.

NENI 28 KONTESTIMET

1. Të gjitha kontestimet që mund të dalin përgjate ekzistencës së Shoqërisë apo gjatë likuidimit të saj, qoftë midis ortakëve dhe Shoqërisë, qoftë dhe midis vetë ortakëve, për punë të aktivitetit apo ekzekutimit të statutit, do t'i nënshtrohen procedurës së arbitrazhit.

2. Secila prej paleve cakton një arbitër, arbitrat e caktuar zgjedhin një arbitër tjetër, në mënyrë që juria të përbehet nga një numur tek antaresh. Kur një gjë e tillë nuk arrihet, gjykata ku ka qendren Shoqëria, e venë në lëvizje nga njëra prej paleve ose një arbitër, procedon me vendim.

3. Instanca arbitrare nuk përfundon me revokimin, vdekjen, pengimin, abstenimin apo tërheqjen apo refuzimin e një arbitri. Gjykata e kontaktuar si më lart cakton një arbitër të ri. Ky vendim nuk rishikohet dhe nuk rishqyrtohet.

4. Arbitrat nuk detyrohen të ndjekin rregullat e gjykates. Ata do të vendosin si keshilltare miqësore në formën e një vendimi të parë jopërfundimtar, përderisa palet bien dakord shprehimisht që të mos heqin dorë nga rruga e apelit.

6. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet ortakëve ose edhe ndërmjet Shoqërisë dhe të tjerëve, kompetente është gjykata.

NENI 29 REGJISTRIMI - PUBLICITETI - FUQITE

1. Shoqëria e fiton personalitetin juridik duke filluar nga data e regjistrimit në gjykate në regjistrin e shoqërive tregtare.

2. Megjithatë, para nënshkrimit të statutit, janë kryer për llogari të Shoqërisë në krijim, aktet e përmendura në një aneks të këtij statuti, dhe që tregojnë për secilin prej tyre angazhimin që rezultonte për Shoqërinë.

3. Ky situacion depozitohet në afatet ligjore në qendrën e ardhshme, i cili do të mbetet aneks i statutit.

Statuti i Shoqërisë "UNIONI FINANCIAR I TIRANES", nënshkruhet rregullisht me Tirane, ____ / Shkurt 1995

Edmond LEKA

Genc MEZINI

Adrian SHEHU

Niko LEKA

Luljeta SHYTI

Saimir DEDE

Leonard NIMALI

Gjergj MISHA

Edmond SHIMA